



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ . _____ . 2022

VENDIM

Nr. 185, datë 12.05.2022

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: Dërgim në gjyq.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Yrfet Shkreli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Akuza: Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, neni 79 c dhe 22 i Kodit Penal.

2. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli dhe Yrfet Shkreli, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 100/1 dhe 110/1 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, çështjen

gjqësore me Kërkues: {...}; Akuza: “Kërkesë për ndjekje penale për gjyqtaren {...}për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 300 të Kodit Penal, etj.”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Ersida Bajgora, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Vrasje në rrethana cilësuese.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Ersida Bajgora, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen gjyqësore me të pandehur: Kërkues: {...}; Objekti: Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}, etj.; E paditur: {...}; Objekti: “Detyrimi i palëve të paditura, të na shpërblejë ne paditësve dëmin e shkaktuar”.

2. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Sokol Ibi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.5, datë 25.6.1999, etj.”.

3. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}etj; Objekti: Kundërshtim i pjesshëm i aktit “Lista e trojeve dhe shtëpive në fshatin {...}r” si dhe regjistrimit të kryer nga pala e paditur Z.V.R.P.P Tepelenë etj.

4. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Sokol Ibi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e akteve administrative, deri në përfundimin e çështjes me vendim të formës së prerë. Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të akteve administrative”.

5. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}, {...}; Objekti: Shfuqizim i vendimit nr.13 datë 21.03.2018 për prishjen e objektit dhe vendimit për dënim me gjobë me nr. 14 datë 21.03.2018 në adresë të paditësit;

6. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi dhe Sokol Ibi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Detyrimin e të paditurit për të paguar 1,024,588 lekë që është detyrim i papaguar për kontratën e sipërmarrjes të datës 25.10.2017 etj.

7. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi dhe Sokol Ibi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës{...}; I paditur: {...}, {...}; Objekti: Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të kontratës së shitjes me nr. 340 rep dhe nr. 96 kol, datë 17.07.2003 përsa i takon sipërfaqes prej 99.5 m2 etj.

8. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi dhe Sokol Ibi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}’ sh.p.k; E paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimin tërësisht të shkresës nr.5199/1, datë 20.10.2021 të Bashkisë Sarandë”.

9. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; Të paditur{...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë; Objekti: “Shpërblim dëmi”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: Dërgimi i çështjes për gjykim.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; I akuzuar për kryerjen e veprës penale: Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve, Mosbindje ndaj urdhërit të policisë së rendit publik, Prodhim dhe shitje të narkotikëve.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; I akuzuar për kryerjen e veprës penale: Përndjekje; Viktima e veprës penale: {...}.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Trafikim i narkotikëve, mbetur në tentativë”, etj.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur{...}, {...}, etj.; Akuza: “Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR